



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 512/2022
Datë: 14 prill 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Prokurores Ferdane Sylejmani, Prokuroria Themelore në Prishtinë, në pajtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Marrëveshjes vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore AD.nr.02/2022, të datës 05 prill 2022, gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 14 prill 2022, në seancën e këshillimit dhe votimit morri këtë:

VENDIM

- I. **MIRATOHET** marrëveshja vullnetare për shkeljen disiplinore AD.nr.02/2022, e datës 05 prill 2022, e lidhur në mes Panelit Hetimor dhe subjektit të hetimit disiplinor Prokurores Ferdane Sylejmani, Prokuroria Themelore në Prishtinë.
- II. Prokurores Ferdane Sylejmani i shqiptohet sanksioni disiplinor **“Vërejtje publike me shkrim”** konform nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- III. Marrëveshja vullnetare për shkeljen disiplinore dhe sanksioni disiplinor i miratuar nga Paneli Hetimor do të ketë të njëjtin efekt ligjor sikurse vendimi i Këshillit për shkelje disiplinore, konform nenit 13 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'u dërgohet:

- Z. Kujtim Munishi, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë
- Znj. Ferdane Sylejmani, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë
- Arkivot të KPK-së